

Kryetari i KLSH-së z. Arben Shehu zhvillon një vizitë zyrtare në Institucionin Suprem të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu ka zhvilluar në datat 29-30 maj 2023, me ftesë të Sh.T. Humaid Obaid Abushibs, President i SAI-t, një vizitë zyrtare pranë Institucionit Suprem të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe.



Kryetari i KLSH-së falenderoi Presidentin Abushibs për pritjen e veçantë dhe organizimin e vizitës, si dhe i prezantoi homologut një kuadër të përgjithshëm të organizimit dhe funksionimit të institucionit të KLSH-së. Z. Shehu e vuri theksin në fjalën e tij tek rëndësia dhe vlera e shtuar që

ka për KLSH-në bashkëpunimi me SAI-t homologë, në veçanti ngritja dhe thellimi i bashkëpunimit me Institucionin Suprem të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe në fushat me interes të përbashkët, si në fushën e auditimit IT dhe të burimeve natyrore.

Gjithashtu një vend të veçantë gjatë bashkëbisedimit zuri edhe diskutimi mbi punën e vazhdueshme që bëhet në parandalimin e fenomeneve që nxisin korrupsionin nëpërmjet forcimit të kulturës së llogaridhënies.

Presidenti Abushibs nga ana e tij e falenderoi z. Shehu për vizitën dhe shprehu besimin e plotë dhe vlerësimet e tij për këtë bashkëpunim të ndërsjellë, me qëllim shkëmbimin dhe të mësuarin nga eksperiencat dhe praktikat më të mira të ndërsjella.



Z. Shehu dhe Presidenti Abushibs shprehën angazhimin dhe vullnetin e plotë në thellimin e këtij partneriteti të suksesshëm që do të vijojë me ngritjen e një grupi pune të përbashkët për përcaktimin dhe identifikimin e fushave dhe hapave konkretë për bashkëpunim duke u finalizuar me nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet dy institucioneve.

Kryetari i KLSH-së në këtë vizitë shoqërohej nga znj. Marjola Llanaj, Drejtor i Përgjithshëm, znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm, z. Bexhet Zeqiri, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë në Auditim, si dhe znj. Dëshira Huqi, Përgjegjës sektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Bashkëpunimin.